

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kush është grupi i ekstremit të djathtë
ADRESA	https://shqiptarja.com/lajm/kush-eshte-grupi-i-ekstremi-te-djathte-patriot-platform-qe-fshihet-pas-protestave-antiemigrante-ne-angli
BURIMI	shqiptarja.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	8 shtator 2026, 07:41:56 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	7 shtator 2026, 13:57:12 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	7ca3d392b1ea4e5ba60f0e14f9474a4d69101a7cb05fe0cfe35bd12cfa9df558
TEKSTI	46043aa3f2f7b149293733a8654d9d6d5f4bafcf764adbc568e359f12e66e03b
PAMJA	ba0bbf099b532ad7f929f659bad4ba08c4317eeae29d01818c3f29324afc62fc

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	31dc289d7f75593a907d74ecb7f39ac4691ae918e8e0907c2ae9c3ae3b5f0133
E MËPARSHMJA	7e7455d0e7886281992af5ed5d95879583eb7a137843453df387c362dcf4c853
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/31dc289d7f75593a907d74ecb7f39ac4691ae918e8e0907c2ae9c3ae3b5f0133>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



Zjarr në një banesë në Bulqizë, shpeton mrekullisht i riu me aftësi të kufizuara: Fqinjët më ndihmuan që të dal jashtë



Bota

Kush është grupi i ekstremit të djathtë 'Patriot Platform' që fshihet pas protestave anti-emigrantë në Angli

Me qindra protestues të maskuar dolën në rrugë për të bllokuar transferimin e emigrantëve në Dover dhe Portsmouth. Pas organizimit të tyre qëndron **"Patriot Platform"**, një grup i ekstremit të djathtë që, sipas organizatës Hope Not Hate, ka në radhët e tij persona me precedentë penalë.



Protestues anti-emigracion në Angli



Redaksia

7 Shtator, 15:51 | Përditësimi: 7 Shtator, 15:57

[f Share](#) [Tweet](#)

A A

Pas protestave dhe përplasjeve me policinë në Dover dhe Portsmouth, vëmendja në Britani është përqendruar te **Patriot Platform**, grupi i ekstremit të djathtë që përmes rrjeteve sociale organizoi bllokimin e rrugëve për të penguar transferimin e emigrantëve të mbërritur me gomone nga Franca.

Sipas *The Guardian*, Patriot Platform nuk është një organizatë e vetme e krijuar rishtazi, por një rrjet që bashkon disa grupe lokale anti-emigracion nën një drejtim të vetëm. Pjesa më e madhe e anëtarëve vijnë nga jugu i Anglisë, ndërsa grupi ka edhe mbështetës nga veriperëndimi i vendit.

Në krye të lëvizjes është **Daniel Thomas**, i njohur si Danny Tommo, një bashkëpunëtor i ngushtë i ekstremistit britanik Stephen Yaxley-Lennon, i njohur me emrin Tommy Robinson. Sipas organizatës Hope Not Hate, e cila monitoron grupet e ekstremit të djathtë, Thomas ka zgjedhur personalisht aktivistët e Patriot Platform, duke deklaruar se ka preferuar "cilësinë para sasisë".



LEXO EDHE:

Transportonte 7 emigrantë të paligjshëm drejt Tiranës, arrestohet 32-vjeçari në Korçë! Në kërkim bashkëpunëtori që i iku policisë

Edhe pse Thomas pretendon se kërkon "disiplinë" dhe jo dhunë, Hope Not Hate thotë se në radhët e grupit ka persona me precedentë penalë. Vetë Thomas ka vuajtur dënim me burg për përfshirje në një tentativë rrëmbimi, ndërsa në janar ai ishte mes dhjetë aktivistëve britanikë anti-emigracion të cilëve Franca u ndaloi hyrjen në territorin e saj.



Protesta e parë u mbajt të shtunën në Dover, ku qindra aktivistë të veshur me të zeza bllokuan rrugën A20, hyrjen kryesore drejt portit, duke shkaktuar trafik të rënduar. Ata brohoritën slogane si "Stop the boats" dhe "England till I die", ndërsa jashtë një qendre ku përpunohen emigrantët u shkrua me bojë mesazhi "Blood is on your hands" ("Gjaku është në duart tuaja").

Sipas policisë së Kentit, protesta u cilësua si spontane dhe nuk pati të arrestuar, megjithëse grupi kishte paralajmëruar prej ditësh në rrjetet sociale se po përgatiste një aksion. Deputeti laburist Mike Tapp ngriti pikëpyetje mbi reagimin e autoriteteve, duke thënë se një protestë e koordinuar nuk mund të konsiderohej spontane.

Pak orë më vonë, Patriot Platform organizoi një tjetër protestë në Portsmouth, pasi një gomone me emigrantë u soll në port. Sipas *The Guardian*, vetë Danny Tommo u bëri thirrje mbështetësve përmes një transmetimi live që t'i bashkoheshin protestës, e cila më pas u shoqërua me përplasje me policinë.

U.D/Shqiptarja.com

TAG: [angli](#) [Britani e Madhe](#) [Patriot Platform](#) [Daniel Thomas](#) [emigrante te paligjshem](#)

Sa e vlerësoni këtë artikull?  2.3 / 5 (3 vlerësime)



Komente

[Komento](#)

 Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH
COM

Sondazhi i ditës:
Haga dënon me 81 vite burg 4 ish-krerët e UÇK-së, si e vlerësoni?

16 Shtator, 14:18

[Të drejtë](#) [Të gabuar](#) [Nuk e di](#)

Lajme të tjera



U kap duke transportuar 6 emigrantë sudanez drejt Tiranës, arrestohet 23-vjeçari në Devoll

16 Shtator, 09:35



Angli/ Dënohet agjenti imobiliar, i siguroi shqiptarëve 19 shtëpi për të mbjellë kanabis

13 Shtator, 17:06



Makina Benz e papaguar në 2017-ën prangos shkodranin në Angli, nis procesi i ekstradimit (EMRI)

13 Shtator, 13:48



Një prej veshjeve më ikonike, 'fustani i hakmarrjes' i Princeshë Dianës del në ankand për 300 mijë dollarë

11 Shtator, 08:43



Pse u bllokua kontrolli ajror në Britani? Gabimi në dokumentin ushtarak çoi në anulimin e mbi 2 mijë fluturimeve! Ekspertët: Sistemi NATS i vjetër dhe i vështirë për t'u menaxhuar



Leonard Berberi

9 Shtator, 16:45



Kaosi me fluturimet në Britaninë e Madhe prek qindra pasagjerë shqiptarë! Anulime dhe vonesa në 7 fluturime me Londrën dhe Mançesterin (FOTO)

8 Shtator, 21:29



Britania thërret ambasadorin serb për



Britania, Franca dhe Kanada ja vendosin



Britania në kaos pas defektit në kontrollin

**sqarime pas nderimeve
për Mlladiçin: Glorifikimi i
një kriminelit lufte nxit
përçarjet në rajon**

8 Shtator, 19:05



**Spanja nis hetim penal
për hyrjen e mbi 70 mijë
emigrantëve në Ceuta**

7 Shtator, 20:14

**sanksione tregtare ndaj
kolonive hebreje në
Bregun Perëndimor,
Londra: Atje po ndodh
spastrim etnik! Izraeli:
Mbyllim konsullatën
britanike në Jeruzalem**

8 Shtator, 17:31



**Britani, protestuesit
bllokojnë rrugët për të
ndaluar autobusët me
emigrantë, përplasje me
policinë në qytetin
portual të Portsmouth-it
(VIDEO)**

7 Shtator, 15:44

**ajror! Anullohen mbi
1.100 fluturime, 170 mijë
pasagjerë të bllokuar!
Priten vonesa zinxhir në
Europë**

8 Shtator, 17:18



**BE kopjon 'Gjadrin'/ Pesë
vende europiane synojnë
qendra deportimi jashtë
BE-së, transferimet nga
2027**

5 Shtator, 17:08

Kodi Etik

Kontakt

Rreth Nesh

Raportoni Ju

Puno me ne

[Shqiptarja.com]

Kërko

© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohej riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.